

Siguria në makinë



Për sigurinë e fëmijës suaj, është e rëndësishme që fëmija të ketë një ndenjësë të përshtatshme në makinë. Ndenjësja duhet të montohet duke ndjekur me përpikmëri udhëzimet e prodhuesit.

Që nga 1 prilli 2010, ndenjësja është e detyrueshme për fëmijët deri në 12 vjeç ose që janë me gjatësi më të vogël se 150 cm

Çfarë thotë ligji



Grupi 0+ më pak 13 kg

Foshnja udhëton në një ulësë të pajisur me një kapëse me tre pika që instalohet me shpinë nga rruga. Ky fiksohet me ndihmën e rripit të sigurisë, ose me ndihmën e një shtrati tip Isofix të palëvizshëm që lejon vendosjen e shpejtë të mbajtëses së fëmijës për çdo lëvizje.



Grupi 1 nga 9 deri në 18 kg

Fëmija mbahet në ndenjësën e tij nga një kapëse me pesë pika të integruara në ndenjësën prapa, përballë ose me shpinë nga rruga në varësi të ndenjësës së zgjedhur.




Grupi 2-3 nga 15 deri në 36 kg ose më shumë.

Në këto kategori, ka sedilje pak të ngritura me mbështetëse për trupin dhe kokën. Fëmija është i lidhur me rripin e sigurisë që mban njëkohësisht ndenjësën dhe fëmijën.

Disa këshilla

- Kur është e mundur, preferohet që ndenjësja e fëmijës të fiksohet në pjesën e pasme. Nëse e fiksoni në pjesën e përparme, çaktivizoni airbag-un.
- Zgjidhni një ndenjësje të miratuar (shih etiketën portokalli në faqen e nternetit të TCS) të përshtatur me madhësinë e fëmijës suaj dhe sa më të rehatshme.
- Mos e ndryshoni madhësinë e ndenjësjes veç nëse koka e fëmijës e tejkalon atë. Kontrolloni nëse ndenjësja është e instaluar dhe e fiksuar mirë sa herë të përdoret.
- Kini kujdes për mënyrën se si e lidhni fëmijën tuaj : i përdredhur, i fiksuar lirshëm, ose duke kaluar afër qafës, rripi do të jetë i paefektshëm !
- Zbërtheni xhaketat e dimrit ose i hiqni në mënyrë që rripi të rrafshohet mirë me trupin.



Reflekse të mira

- E lidh gjithmonë fëmijën tim në ndenjësën e tij, edhe për një udhëtim të shkurtër, nuk e mbaj kurrë as në prehrin tim, as në prehrin e dikujt tjetër.
- Gjatë udhëtimeve të gjata, një pushim është i nevojshëm çdo dy orë. Kjo krijon mundësinë të nxirret fëmija nga ndenjësja e tij, të ushqehet, të ndërrohet, e të pijë, veçanërisht kur bën nxehtë
- E mbroj nga dielli ose me një çadër dielli, ose me një leckë të fiksuar me xhamin e dritares.
- Është e rrezikshme për shëndetin e fëmijës suaj të pini duhan në makinë.
- Rafti pas sediljeve duhet të jetë bosh për të shmangur rënien e objekteve në rast frenimi ose përplasjeje të papritur.

E rëndësishme

- Vendet më të sigurta janë sediljet e pasme, duke përfshirë edhe fëmijët më të rritur.
- Mos e lini kurrë fëmijën tuaj vetëm në makinë.
- Sigurohuni që rripi të jetë i shtrënguar dhe i drejtuar mirë.
- Disa adresa interneti : www.bpa.ch – www.tcs.ch www.pipades.ch

Ndenjësja e përshtatur, foshnja e lidhr mirë, udhëtim i sigurtë !



Programme cantonal de promotion de la santé et de prévention primaire enfants (0-4 ans) - parents



Section VD NE JU
Fédération Suisse de Sages-Femmes

